



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
NR 76 DATË 24/12/2021

**"MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË NDIHMËS SË
MENJËHERSHME FINANCIARE PËR FAMILJET NË NEVOJË PËR VITIN 2021 NË
MASËN 20.000 (njëzet mijë) LEKË PËR FAMILJEN E ZNJ. NATASHA ÇEPELE**

Këshilli i Bashkisë Dimal i mbledhur më datë 24/12/2021, mbi bazën e materialit të paraqitur dhe relatuar nga Sektori i Ndihmës Ekonomike në Bashkinë Dimal, në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenet neni 9, pika 1/1a dhe 1/1b 41, 53 54 dhe 55; mbështetur në kërkesat e nenit 32 të ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe në vijim, ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar; Ligji 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimi nr. 10, date 28.02.2020 "Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023" dhe shtojcat plotësuese; Udhëzimi nr. 27, date 10.07.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023, Ligjit Nr. 9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar, VKB nr.81, datë 24.12.2020 "Për miratimin e buxhetit afatmesëm 2021-2023" dhe Buxhetin e Detajuar 2021, konfirmim i bazueshmërisë ligjore nga Institucioni i Prefektit për VKB nr. 81, datë 24.12.2020, shkresa me nr. 1119/3 prot, datë 08.01.2021

VENDOSI

Me 13 VOTA PRO nga 13 Këshilltarë prezentë të miratojë:

1. Të miratojë përdorimin e Fondit Ndhmës së Menjëhershme Financiare për familjet në nevojë për vitin 2021 në masën 20.000 (njëzet mijë) lekë për familjen e Znj.Natasha Çepele , banuese në fshatin Konizbaltë të Bashkisë Dimal.
2. Të miratojë përdorimin e Fondit të Ndhmës së Menjëhershme Financiare, në masën 20.000 (njëzet mijë) lekë për familjen e Znj. **Natasha Çepele**,familje në gjendje të vështirë ekonomike,duke e pasur të vështirë të përballojë kushtet minimale për jetesën .

Shënim: Fondi për vitin 2021 në masën 20.000 (njëzet mijë) lekë, do të përballohet nga fondi ndihmë për familjet në nevojë i parashikuar në Buxhetin afatmesëm të Bashkisë Dimal “Ura Vajgurore” për vitin 2021-2023 dhe Buxhetin e Detajuar 2021.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Hysen Hoxha



